



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 36
Prishtinë, më 02. 04. 2010, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Ibrahim Gashi,
Ardian Gjini dhe Sllobodan Petroviq.

Munguan: Enis Kervan, Lutfi Haziri dhe Nexhat Daci.

Nga pjesëmarrësit e tjerë : Lumnije Murati-ZPRK dhe Visar Ramaj – KDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 02, 08 dhe 15 mars 2010;**
- 3. Miratimi i Raportit me rekomandime të Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare nr. 03/L-183;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 02. 08 dhe 15. 03. 2010

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 02, 08 dhe 15. 03. 2010 u miratuan njëzëri.

3. Miratimi i Raportit me rekomandime të Projektligjit për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare nr. 03/L-183

Sabri Hamiti – I njoftoi anëtarët e Komisionit se pas shqyrtimit të Projektligjit dhe miratimit të amendamenteve në cilësi të Komisionit Funkcional, janë përcjellë amendamentet për shqyrtim te komisionet kryesore.

Komisionet kryesore e kanë shqyrtuar Projektligjin me amendamente e propozuara dhe i kanë përcjellë rekomandimet e tyre, të cilat janë inkorporuar në Raportin për Projektligjin.

Komisioni pas shqyrtimit të Raportit me rekomandime në Projektligjin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare nxori këtë

P ë r f u n d i m

Raporti me rekomandime për Projektligjin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare nr. 03/L-183, të procedohet për miratim në seancë plenare.

4. Të ndryshme.

Anëtarët e Komisionit: I. Gashi, R. Buja, Xh. Haliti, A. Gjini, S. Hamiti, e S. Petroviq diskutuan për ndërprerjen e disa të drejtave që i ka gëzuar diaspora jonë në shtetin e Zvicrës. Diskutuan se kjo mund të jetë për shkak se tani palë e nënshkrimit të marrëveshjes duhet të jetë shteti i Kosovës, si dhe i ndryshimeve të sigurimeve shëndetësore në sistemin tonë.

Komisioni konstatoi se problemi është evident dhe mund ta prekë edhe diasporën në shtetet e tjera, në këtë drejtim i mbështet institucionet e Kosovës, Qeverinë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, që t'i shqyrtojnë hollësisht shkaqet e kësaj shtate dhe të reagojnë.

Mbledhja përfundoi në orën 10: 20.

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetje të Komisionit